



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 139/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit N.T “E....”, me NRF:....., rr. “....”, me seli në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 81/2018 të datës 27.02.2018 të Përmbartuesit Privat Fatos Shatri, me seli në Istog, jashtë seancës me datën 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.T “E....”, me NRF:....., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 81/2018 të datës 27.02.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fatos Shatri, me seli në Istog.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 81/2018 të datës 27.02.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fatos Shatri, me seli në Istog.

A r s y e t i m

Kreditori, Dogana e Kosovës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit N. N.T “E....”, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017-1156, i datës 13.11.2017, i formës së prerë me datë 18.12.2017 dhe i ekzekutueshëm me datë 19.01.2018, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës për kundërvajtje doganore t’ia paguaj shumën prej 1,250.00 € (një mijë e dyqind e pesëdhjetë euro), pas pranimit të Aktvendimit, në xhirollogarinë e Doganës së Kosovës – Sektorit Anti-Kontrabandë.

Përmbartuesi Privat Fatos Shatri, me seli në Istog, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, me datë 27.02.2018, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr 81/2018, me të

cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017-1156, i datës 13.11.2017.

Kreditori në propozimin për përmbarim të datës 27.02.2018, ka kërkuar që të detyrohet debitori N.T “E...”, që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit Dogana e Kosovës, gjobën në shumën prej 1,250.00€ (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë euro) nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, nëse debitori nuk e përmbush detyrimin i njëjti të ngarkohet me kamatë vonesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet tjera të krijuara, sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori ka parashtruar prapësim me shkrim në të cilin ka deklaruar se i njëjti i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për të sqaruar me kreditorin se ka ndodhur një keqkuptim pasi që në sasia e artikujve dhe mallit të konfiskuar nuk ka qenë në atë vlerë, mirëpo nuk kanë arritur marrëveshje dhe si pasojë debitori e ka përmbushur detyrimin që e kishte ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të marr vendim për abrogimin e urdhrit përmbarimor si të pabazuar juridikisht dhe të pa mbështetur.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbarimor Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017-1156, i datës 13.11.2017, në bazë të të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për

realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017-1156, i datës 13.11.2017, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017-1156, i datës 13.11.2017, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje nr.03.1.7-2017-1156, i datës 13.11.2017, është bërë i formës së prerë me datë 18.12.2017 dhe i ekzekutueshëm me datë 19.01.2018.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara pasi që debitori nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të mund të vërtetoheshin pretendimet e tilla. Po ashtu në konkluzionin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë i cili gjindet në shkresat e lëndës, është obliguar debitori që gjykatës t’ia sjellë dëshmitë/provat me të cilën do të mund të vërtetohesh pretendimi se i njëjti e ka përmbushur detyrimin që ka ndaj kreditorit, mirëpo edhe pas pranimit të konkluzionit, gjykatës nuk i ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara.

Më tej gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së

vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Nga arsyet e paraqitura më lartë, në bazë të nenit 21, 22 par.1 pika 1.2, 27, 36 par.1 dhe 2 dhe 73 par.3 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.139/22, datë 02.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.